



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.155, datë 13.11.2020

“PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 157, DATË 26.12.2019, TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2020- 2022 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2020”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b”, pika 1.3 shkronja “c” nenit 41, pika 1, neni 54, shkronja “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, nenit 43 dhe nenit 44, të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 307 datë 16.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit dhe ndërtimit të infrastrukturës publike, në funksion të rindërtimit të banesave individuale dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese” të ndryshuar, udhëzimit plotësues nr. 2 datë 20.01.2020, të ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, të ministrit të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

Në vendimin nr. 157, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në nënpikën 1, të pikës 1, të miratojë një pakësim në planin e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020 në shumën 53,724,978 (pesëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e njëzet e katër mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë të përbërë nga:

a) shtesa e fondit të trashëguar nga viti 2019, sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit të Tiranës, në shumën 1,829,022 (një milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e njëzet e dy) lekë;

b) pakësimi i planit të të ardhurave të vitit 2020, në shumën 55,554,000 (pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër mijë) lekë, sipas pasqyrës Nr.1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Në zbatim të pikës nr.1, të miratojë detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve të shpenzimeve korrente dhe kapitale ndërmjet programeve buxhetore sipas pasqyrës nr. 2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Të miratojë rishpërndarjen dhe detajimin e shtesës së fondeve të rindërtimit akorduar në formën e transfertës së pakushtëzuar për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në Bashkinë Tiranë në programet e Shërbimeve Publike Vendore dhe Arsimin Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor sipas pasqyrës nr. 3, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Të miratojë detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve të akorduara nga donatori në vitin 2019 dhe vitin 2020 sipas pasqyrave nr. 4 dhe nr.4.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

5. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Agjencia e Shërbimeve Funerale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

ZV/K R Y E T A R